TROPOJA

"ERA E NDRYSHIMIT QË PËRKUND TË ARDHMEN TONË

Revista Promovuese e Bashkisë Tropojë, Nr.2

NR.2

JANAR 2022

BOTUES:

Bashkia Tropojë

ADRESA:

BASHKIA TROPOJË

Sheshi "Azem Hajdari"
Kodi postar 8701
Bajram Curri, Tropojë, Shqipëri

E-MAIL:
info@tropoje.gov.al

ADRESA ELEKTRONIKE:
https://tropoje.gov.al/

FACEBOOK:

Bashkia e Tropojës

WEB:

www.bashkiatropojë.gov.al

SHTYPI
Dukagjini: ”Pejë”

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË BASHKISË

Të nderuar bashkëqytetarë,

Në respektin tuaj Bashkia jonë boton këtë reviste vjetore e cila ne thelb nuk është një paradë arritjesh, por një libër i hapur transparence, të cilën jua kemi për detyrë bashkëqytetarëve.

Një vit i vështirë ky që lamë pas dhe i dyti radhazi për shkaqe që tashmë i njeh dhe i konsideron mbarë njerëzimi.Por falë Zotit, vullnetit të stafit që drejtoj, por dhe të mbështetjes masive qytetare, që më kanë shoqëruar çdo ditë të mandatit tim, kemi arritur të tejkalojmë vështirësite dhe te ecim me normalitet në të gjithë sektorët,kryesisht atë të shërbimit publik.

- Tropoja në vitin 2021 shënoi një rekord kombëtar e rajonal të pritjes së turistëve, duke e tejkaluar me 43.5 % vitin më të suksesshëm 2019.
- Duke unvestuar e punuar me seriozitet në Unazën e Bjeshkëve, vitin qe kaloi ,atje u priten rreth 56.000 turistë e mysafirë, duke i dhënë një shtysë serioze turizmit familjar, i cili në fakt përkthehet në të ardhura direkte finaciare,si dhe në zgjerim të bujtinave, por dhe të mbledhjes masive të bimeve medicinale.
- -Ujitja e tokave ka qene prioritet i imi, ndaj megjithë thatësiren kombëtare Tropoja arriti të ketë furnizim sistematik si dhe një rrjet vaditës të përmirësuar nga themelet.
- Duke qenë një zonë turistike e destinacion nga më të rëndësishmit nacional ndërhyrja në infrastrukturë ka qenë imperative.
- Dhjetera segmente infrastrukturore rurale janë filluar dhe shumica prej tyre po shkojnë drejt përfundimit. Duhet theksuar se këto investime të domosdoshme janë kryer me paratë dhe të ardhurat ekskluzive të Bashkisë Tropojë, duke kursyer e mirëperdorur si asnjëherë me parë paranë publike.
- Vitin që shkoi Tropojën e vizituan dhe shprehën konsideratë superiore personalitete diplomatike si Ambasadori i BE-se Luigi Soreca, Ambasadorët.e SHBA, Japonisë, Francës, Austrisë, Spanjës etj, duke premtuar dhe ndihma e donacione në të ardhmen.
- Në bashkëpunim me Këshillin bashkiak kam ndërmarrë sistematikisht nisma për nderimin e personaliteteve kontribues të vecante në gjithë sferat e jetës dhe historisë së Tropojës, si një repekt human, por dhe kujtesë krenarie për brezat që vijnë.
- Punesimi sidomos i te rinjëve e të rejave të shkolluar në administratë ka qenë fokus parësor i punës time dhe ka rezultuar në rifreskimin 64% me të rinj, ku 60% e tyre janë vajza.Ky trend do të vijojë pasi shkollimi,kultivimi dhe punësimi i rinisë ka të bëjë me të ardhmen shoqerore dhe ekonomike të Tropojës.

- Punë themelore janë bërë dhe në qytet në mënyrë që edhe Bajram Curri me resurset e tij ti shtohet hartës së atraksioneve të shumta të Malësisë së Gjakovës.Stadiumi i lojrave me dorë i rikonstruktuar tërësisht , por dhe punimet në përfundimin e Unazës infrastrukturore të qytetit,por dhe ndërhyrjet nëpër lagje ku nuk është vënë dorë për 30 vite, do ta kthejnë qytetin tonë në një balkon turistik të veçantë alpin.
  - Dua të theksoj se përvec punimeve bazike të përditëshme të pastrimit e gjelbërimit objekt i punës time dhe stafit tim kanë qenë dhe investime publike të injoruara më parë siç janë Varrezat e Dëshmorëve dhe ato të qytetit.

Te nderuar miq dhe lexues të këtij libri transparencë!

Unë përmenda në respekt të punës tonë dhe mbështetjes tuaj vetëm disa raste investimi e pune, por gjithëherë jemi gjetur pranë të gjithë individëve e familjeve në nevoje sidomos në fatkeqësi natyrore e personale, me një frymë të lartë solidariteti dhe kjo do jetë konstante me të gjitha mundësitë tona.

Unë jam i ndërgjegjshëm që megjithëse kemi dhënë maksimunin tonë pritshmëritë dhe nevojat janë të mëdha, por ju garantoj se vullneti dhe përkushtimi ynë do të jetë vetëm në rritje në mënyrë që jo vetëm të kryejmë detyrimet tona në shërbimin ndaj jush, por të lëmë gjurmë të qenësishme në zhvillimin dhe përparimin e vendlindjes, gjithmonë me parimin e pandryshushëm që më prin "Tropoja eshte e para"

Ju faleminderit dhe një vit suksesi e mbarësie për çdo familje të Malësisë së Gjakovës!

DREJTORIA E TURIZMIT, SHERBIMEVE DHE TRANSPORTIT

Drejtoria e Turizmit, Shërbimeve dhe Transportit pranë Bashkisë sëTropojes ka si qellim kryesor të saj ofrimin e shërbimeve për banorët. Këto shërbime drejtoria i kryen duke përdorur me efikasitet burimet njerëzore, financiare dhe mjetet teknologjike që ka në dispozicion. Shërbimet kryesore që mbulon drejtoria jonë janë:

Pastrimin dhe largimin e mbetjeve urbane dhe inerte, mirëmbajtjen e godinave kulturore , arsimore ,muzeale, mirëmbajten dhe rritjen e hapësirave të gjelbra,të parqeve , lulishteve , hapjen e rrugëve të reja rurale dhe mirëmbajtjen e atyre egzistuese , mbrojtjen dhe kujdesin për ambjentin , parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, promovimin e Turizmit, aktivitete të ndryshme kulturore, dhenien e ndihmave financiare në rastet e fatkeqësive apo emergjencave, punime në mirëmbajtjen e amave dhe kanaleve (jazeve) vaditëse etj. Me anë të këtyre shërbimeve të ofruara ne si drejtori përmbushim objektivin duke përmiresuar kushtet e jetesës së banoreve.

Gjate realizimit të detyrave te perditshme hasim vështirësi të mëdha. Këto vështirësi vijnë si pasojë e kushteve atmosferike, natyrës së punës që bëjmë, relievit mjaft të thyer, i cili karakterizon territorin e Bashkisë Tropojë dhe mjeteve të amortizuara që ne kemi në dispozicion. Megjithatë falë përkushtimit seriozitettit dhe vullnetin për të punuar ne permbushim me sukses ofrimin e shërbimeve për banorët tanë.

- Marrja e masave për përballimin e sezonit të dimrit, mirëmbajtja dhe hedhja e kripës me makineri në rrugët e qytetit. Hapje e rrugëve nga debora në Njësitë



Administrative të Bashkisë Tropojë për muajt Janar –Mars 2021.

- Dizenfektimi i shesheve, rrugëve, trotuareve në zbatim të masave për parandalimin e pandemisë Covid -19. Respektimi i masave të vendosura nga autoritetet përkatëse për parandalimin e përhapjen e virusit Covid 19.

- Shtimi i sipërfaqeve të gjelbruara eshte shembulli me e mirë për tu kujdesur për natyrën. Fotot e mëposhtme japin një pjesë të procesit të mbjelljes se 3500 rrënjëve (Blina) në të dy anët e rrugës në aksin Bajram Curri – Dubravë -Ura e Bujanit – Cerrnicë – Sopot –Tropoje e vjetër.

- Sic dihet sezoni i pranveres dhe vjeshtës sjell tek ne rreshje të dendura të shiut. Gjatë kësaj periudhe këto reshje shoqërohen dhe me dëmtime të shumta në shtëpi, rrugë, kanale etj. Hapja e rrugëvë të bllokuara nga rrëshqitjet e gurëve dhe dherave.

- Banorët e Tropojës sic dihet jetesën e kanë të lidhur ngushtë dhe me bjeshkët e tyre dhe mund të quhet si shtëpia e dytë , prandaj lëvizja e lirë e tyre me automjetet dhe bagëtinë është një objektiv i drejtorisë tonë. Gjate periudhës **Maj-Shtator 2021** Drejtoria e Turizmit, Sherbimeve Publike dhe Transportit ka ndërhyrë për hapjen dhe rregullimin e segmentit rrugor nga Mulliri i Gradit –Sylbicë-Doberdol –Poligajë-Markofçe –Çerem –Kika me një gjatësi mbi 50 Km . Këto ndërhyrje konsistojnë në hapje rruge, largime dherash , të gurëve , zgjerimin e saj , hapjen e kanaleve anësore , vendosjen e tubave për kullim, shtrimin e rrugës .

Me poshtë jepen në mënyrë të përmbledhur çaste nga proceset e punës. Punime në rrugën e bjeshkës në afërsi të Mullirit të Gradit:

Pjesë nga punimet e kryera në Rreshkëz, rruga e Sylbicës.

Punime të kryera nga fundi i qershorit për largimin e dëborës dhe zhbllokimin e rrugës së bjeshkës në vendin e quajtur Qafa e Doberdolit, sic shihet trashësia e dëborës është mbi 4 metër.

Falë kordinimit të punës dhe nje stafi të përkushtuar paralelisht është hapur edhe rruga në vendin e quajtur Qafa e Markofçës me automjetin tjetër tip fadrome JCB 3CX .

Punime të kryera në aksin Doberdol –Poligaje –Markofçe-Çerem. Këto punime konsistojnë në zgjerimin e transhesë, hapjen e kanaleve anësore, vendosjen e tubave për kullim , largimin e dherave etj. Proceset e punës ilustrohen në fotot e mëposhtme:

Një premtim i mbajtur i Bashkisë Tropojë është edhe hapja e rrugës që lidh fshatin Bricë me qendrën e Lekbiba-je me një gjatësi 5 km, duke e pasuruar inventarin e rrugëve rurale të Bashkisë Tropojë dhe me nje segment tjetër. Foto nga punimet në këtë segment dhe përurimi i kësaj rruge.

Hapja e rrugës për në fshatin turistik Curraj i Epër , kjo rrugë është bllokuar nga rrëshqitjet e dherave dhe rrëzimi i pemëve gjatë periudhës së dimrit .

Falë përkushtimit të punonjësve të pastrimit, largimi i mbetjeve dhe inerteve është bërë e mundur largimi i mbetjeve dhe mbajtja pastër e ambjentit. Për vitin 2022 synimi ynë eshte zgjerimi i hartës së pastrimit në territorin e Bashkisë Tropojë për të bërë të mundur afrimin e këtij shërbimi për një numër me të madh banorësh . Me poshtë jepen momente nga pastrimi i territorit:

Një problem me të cilin përballemi është zjarrvënia e qëllimshme në pikën e grumbullimit të mbeturinave në Koj. Gjej rastin të përgëzoj ekipin e shërbimeve dhe atë të zjarrfikësve për neutralizimin dhe shuarjen e vatrës së zjarrit në vend depozitimin e mbetjeve në Koj .

Pas shuarjes së zjarrit u bë menjëherë rehabilitimi i Vend-Depozititmit të mbetjeve.

Mirëmbajtja dhe rregullimi i amave dhe kanaleve (jazeve) vaditëse është një tjetër shërbim që drejtoria jonë e kryen me përkushtim dhe vendosmëri. Fotot e mëposhtme ilustrojnë çaste nga punimet në kanalin vaditës të fisit të Gashit:

Në bashkëpunim me batalionin e xhenios,në muajin Korrik 2021 është bërë vendosja e dy urave metalike. Konkretisht ura në fshatin Lugu i Zi,Njësinë Administrative Tropojë dhe ura në lagjen Breçan të Njësisë Administrative Bujan . Siç ilustrohet në foton e mëposhtme:

Gjej rastin të falenderoj dhe ju jam mirënjohës çdo punonjësi/e të Drejtorisë së Turizmit , Shërbimeve dhe Transportit të Bashkisë Tropojë për vullnetin dhe përkushtimin e treguar për kryerjen me sukses të punëve .

Përgatiti : Pergjegjësi i Shërbimeve Publike, Kujtim Sylaj

PUNIME DHE RIKONSTRUKSIONE TË RRUGËVE DHE OBJEKTEVE

Në zbatim të Kontratës Nr.19, datë 18.12.2020, ndërmjet Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tropojë dhe Kontraktorit të Punimeve "Florida Shpk&"4 A-M" Sh.p.k & "Vllaznimi" Sh.p.k për objektin Rikonstruksion i pesë segmenteve Rrugore, Fshati Gri, Bujan, Cerrnicë, Tropojë, afati i punimeve është 12 muaj, 18.12.2021.

1. Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës Bujan-Tpla. Në këtë rrugë janë kryer deri tani:
    - Punimet e gërmimeve dhe të mbushjeve.
    - Punimet për veprat e artit.
    - Punimet e nënshtresave me çakull.

    Pritet të kryhen:
    - Punimet e shtresës së stabilizantit.
    - Punimet e shtresave asfaltike.
    - Punimet për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.

2. Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës Rosujë- Blini i Grisë. Në këtë rrugë janë kryer:

- Punimet e gërmimeve dhe të mbushjeve.
- Punimet për veprat e artit.
- Punimet e nënshtresave me zhavorr.
- Pritet të kryhen:
- Punimet e shtresës së stabilizantit.
- Punimet e shtresave asfaltike.
- Punimet për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.

3. Rikonstruksioni dhe asfaltimi I rrugës së brëndshme Cerrnicë. Në këtë rrugë janë kryer:

- Punimet e gërmimeve dhe të mbushjeve.
- Punimet për veprat e artit.
- Punimet e nënshtresave me çakull.
- Punimet e shtresës së stabilizantit.

Pritet të kryhen:

- Punimet e shtresave asfaltike.
- Punimet për sinjalistikën horizontale dhe vertikale.

4. Rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës Kërrnajë-Zhenaj. Në këtë rrugë janë kryer:

- Punimet e germimeve dhe të mbushjeve.
- Punimet për veprat e artit.

Pritet të kryhen:

- Punimet e nënshtresave me çakull.
- Punimet e stabilizantit.

- Punimet e shtresave asfaltike.
- Punimet për sinjalistiken horizontale dhe vertikale.

5. Rikonstruksioni i rrugës Astë- Myhejan. Në këtë rrugë janë kryer:

- Punimet e gërmimeve dhe të mbushjeve.
- Punimet për veprat e artit.
- Punimet e nënshtresave me çakull.

Pritet të kryhen:

- Punimet e shtresave asfaltike.
- Punimet e stabilizantit dhe të sinjalistikës horizontale dhe vertikale.

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE TURIZMIT I PËRBËRË NGA:

- Përgjegjësja e Emergjencave Civile dhe Turizmit
- Specialist i Emergjencave Civile
- Specialist i Turizmit dhe Redaktimit të Shkresave Zyrtare

Gjatë vitit 2021 duke u mbështetur në legjislacionin për Emergjencat Civile kemi ndjekur dhe jemi munduar të parandalojmë dhe të marrim masat e nevojshme për të gjitha fenomenet natyrore që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe, si dëmtime në banesa të ndryshme të qytetarëve nga reshjet e shumta të shiut,dëbora , zjarret në terren, siperfaqet pyjore, kullota etj.

Gjatë këtij viti janë shqyrtuar kërkesat e qytetarëve të cdo njësie administrative ku kanë qënë mbi 60 (gjashtëdhjetë) kërkesa si dhe janë dhënë ndihma financiare për disa familjarë të dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, kryesisht për:

DËMTIME ÇATISH

SHTËPI TË DJEGURA

RRËSHQITJE TOKE

Bashkia Tropoje gjithmonë u gjendet pranë banorëve të saj në rastin e fatkeqësive të ndodhura

Temperaturat në vëndin tonë kanë qënë relativisht të larta kjo ka bërë që edhe në vendin tonë të këte vatra zjarri në Njësi Administrative të ndryshme.

Duke vlerësuar situatën e shkaktuar nga zjarret në vëndin tone, kemi pasur një rritje të ndjeshme në numër të zjarreve, kjo si pasojë e thatësirës së krijuar nga kushtet e motit i cili ka favorizuar marrjen e përmasave të zjarreve dhe zgjatjen e tyre në kohë.

Të gjitha kapacitetet dhe strukturat e emergjencave civile kanë punuar për normalizimin e tyre dhe kanë qënë në gatishmëri për përballimin e çdo situate emergjente të mundshme.

Sipërfaqe të konsiderueshme pyjesh, shkurresh, kullotash janë përpirë nga flakët ndërkohë që institucionet shqiptare nuk deklarojnë shifra përmbledhëse mbi sipërfaqen totale të shkrumbuar.

Gjithsej në Bashkinë Tropojë ka pasur rreth 10 (dhjetë) vatra zjarri në pyje dhe kullota.

Zjarret e vazhdueshme ne territorin e Bashkisë Tropojë kanë prekur edhe zonat e mbrojtura gjithsej ka pasur 6 (gjashtë) vatra zjarri

Turizmi i cili vitet e fundit është bërë një nga sektorët më të rëndësishëm në rritje të ekonomisë shqiptare dhe është konsideruar nga qeveria si një nga motorët kryesorë të rritjes kombëtare në mënyrë të vecantë për rrethin e Tropojës.

Shqipëria po rekomandohet gjithnjë e më shumë si një destinacion turistik nga operatorë turistikë të ndryshëm dhe udhëzuesit ndërkombëtarë të udhëtimit.

Zhvillimi i vrullshëm i turizmit malor në Tropojë kryesisht në zonën e Valbonës po nxit zinxhirin mbështetës për sektorin, duke ndihmuar qytetin verior të dalë nga varfëria. Po zhvillohen fermat e kafshëve, bletaria dhe sektori i transportit.

Pika turistike e Valbonës, me bukuritë e saj dhe kontributin origjinal të komunitetit të kësaj zone, është kthyer së fundmi në një nga destinacionet më të preferuara për turistët e shumtë të huaj dhe ata vendas.

Gjatë vitit 2021 është bërë edhe evidentimi i çdo subjeti, proces-verbalet për numrin e dhomave dhe të shtretërve, ku ka rezultuar që gjithsej janë:

Gjithsej janë 29 subjekte

- Hotele – 15
- Bujtina -14
- Dhoma -374
- Shtretër – 896

Tropoja, me pasuri të pazëvendësueshme që ja ka dhuruar natyra e bëjnë atë një rajon me vlera të mëdha turistike. Investimet në sektorin e turizmit nga Bashkia Tropojë gjatë vitit 2019 sidomos gjatë sezonit veror,kanë dhënë impakt në fushën e turizmit, ato janë:

- Me datë 11 Qershor 2021 në qytetin e Bajram Currit u hap sezoni turistik i verës me moton **"ÇELJA E SEZONIT TURISTIK VALBONË "**, ku morën pjesë nga të gjitha trevat e vendit , Kukësi, Hasi, Kosova, Plava dhe Guxia, përfaqësues të ndryshëm nga diaspora dhe media të ndryshme. Në aktivitet u bë dhe promovimi i artit kulinar tradicional i kombinuar me atë modern dhe bashkohor, u prezantuan punime të ndryshme druri, guri, punime artistike dhe veshje tradicionale, gjithashtu gatimet e zonës nuk munguan, duke i paraqitur ato në një panair.

- Në 10 qershor 2021 u organizua **"SOFRA DARDANE"** festival mbarë kombëtarë, ku morën pjesë 800 festivaliste nga të gjitha trevat e shqipërisë. Festivali u organizua në qytetin e Bajram Currit me një program shumë të pasur artistik, konkurs, këngë, valle dhe lojra të ndryshme. Në këtë aktivitet morën pjesë dhe operatorë të ndryshëm turistik dhe gazetarë.

- **Festa e Bjeshkëve** me datë 04.08.2021 e cila u realizua në një vend shum të bukur që quhet Lkeni i Ponarve, Njësia Administrative Bujan .

-

- Aktiviteti i cili u organizua me 30 Tetor 2021 **Dita e Gështënjes** (gatimet e këtij panairi do bëheshin kryesisht nga gështënja) Panairi u realizua në qytetin e Bajram Currit.

Në bazë të takimeve dhe bisedave me turistë dhe biznese gjatë vitit 2021 është konstatuar se numri i turistëve është:

- **Vizitor gjithsej - 153445**
- **Mjete gjithsej - 43654**

Në ardhjen e këtyre turistëve ka ndikuar natyra e bukur, mikpritja dhe bujaria e tropojanëve.

Turizmi mund të japë një kontribut të rëndësishëm në tre dimensione të zhvillimit të qëndrueshëm: të krijojë vende pune, të gjenerojë mundësi tregtare për të njohur nevojat dhe mbështetur aktivitetet e turizmit, të krijojë kapacitetet e rëndësishme që promovojnë përparësitë për ruajten mjedisore dhe larminë kulturore. Industria e turizmit zë një vend të rëndësishëm në ekonomi dhe është një burim i madh dhe i rëndësishëm për zhvillimin e vendit.

Gjithashtu në kuadër të luftës kundër lëndëve narkotike, zjarr-vënieve të qëllimshme në bashkëpunim me institucionet e tjera kemi ndërrmarrë nismën e sensibilizimit me banorët e të gjitha Njësive Administrative, që përbëjnë Bashkinë Tropojë. Me poshtë foto nga takimet e mbajtura:

Përgjegjëse e emergjencave civile dhe turizmit

SHQIPE GJYRIQI

SEKTORI I BUJQESISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE TRAJTIMIT TE AMTP.

Tropoja ndodhet në qarkun e Kukësit, ka një sipërfaqe 1043 km2, dhe popullsi mbi 20.000 banore, lartësi mesatare 1105 m mbi nivelin e detit. Qyteti i B.Currit (330 m-390 m) mbi nivel të detit ndodhet në juglindje të Alpeve të veriut. Tropoja ka 8(tete) njësi administrative:

- Nj.Ad. Margegaj,
- Nj.Ad.Bujan,
- Nj.Ad.Fierze,
- Nj.Ad.Llugaj,
- Nj.Ad.Tropojë e vjetër,
- Nj.Ad.Bytyç,
- Nj.Ad.Lekbibaj,
- Qyteti B.Curri.

Tropoja është një zone kryesisht bujqësore dhe blegtorale, Sipërfaqja e tokës bujqësore: Arë -7387 ha, pemtore -1773 ha, vreshta -189 ha, kullota-21441 ha, pyje-43190 ha, tokë jo bujqësore: 31980 ha.

Rezultojnë të regjistruara 4800 ferma, të cilat ushtrojnë aktivitet bujqësor dhe blegtoral në të gjithë bashkinë.

Sot problem kryesor është fragmentarizimi i tokës, gjë e cila krijon problem në adaptimin e skemave te subvencioneve dhe futjes së teknikave te reja, e cila kërkon domosdoshmërisht përfundimin e procesit të regjistrimit të tokes dhe krijimin e tregut të saj. Në bashkinë Tropojë, në mbështetje të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" kanë aplikuar 2500 qytetarë.që kanë paraqitur një kërkesë shoqëruar me fotokopje të dokumentacionit që disponojnë.Kalimi në pronësi i tokës bujqësore bëhet nga ASHK-ja.Ne si sektor kemi bashkpunim me ASHK.

Politika e zhvillimit:

Programi vendor i bujqësise dhe zhvillimit rural ka për qëllim mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet kaotike,saktësimin dhe regjistrimin e të drejtave të pronësisë mbi tokën bujqësore,rehabilitimin në infrastrukturën bujqësore,promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, duke nxitur dhe mbështetur kultivimin e kulturave tradicionale për cdo zone,ndërthurjen e investimeve në sektorin bujqësor me ato të karakterit turistik.

Programi i Bujqësise, Zhvillimit Rural dhe trajtimi i AMTP ka këto politika zhvillim:

- Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermes dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

- Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokës bujqësore si dhe te kategorive të resurseve të tjera,

- Rehabilitimi i rrjetit kullues dhe vaditës ekzistues dhe zgjerimi i tyre në të gjithë territorin që mbulon Bashkia Tropoje.
- Mbështetja për përmirësimin e konkurueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve.
- Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave dhe të kooperativave të prodhuesve bujqësor dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësor dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare,

Në kuadër të Ligjit nr.139/2015 "Për qeverisjen Vendore" Bashkia Tropojë ka përgjëgjësinë të punojë për zbatimin e detyrave te mësiperme.

Fshati Sopot Nj. Ad. Tropojë e vjetër. Foto.nr.1

Fshati Shoshan Nj.Ad.Margegaj Foto nr.2

Punonjësit e Sektorit Buqësisë

- Përgjegjësi i Sektorit ing. Muhamet Kuçana
- Specialistja Mire Gjoçaj
- Specialisti z. Ervis Mahmutaj

HISTORI E URBANISTIKËS DHE NDERTIMTARISË NË TROPOJË

"Urbanistika dhe Arkitektura jane padyshim ato që lënë gjurmë te pashlyeshme në zhvillimin e një vendi."

(Përpjekje për me lanë diçka të shkruar në kujtim të atyre që dhanë gjithçka)

Zyra e Urbanistikës dhe Projektimit, ZUP, në Tropojë, është krijuar në vitin 1967, me këtë organikë:
Ark. Pirro Dilo, nga Gjirokastra - përgjegjës, Inxh. Dhurata Struga, nga Tirana - konstruktore, Tek. Ahmet Dega - pèrpunues, Top. Muhamet Katana - topograf."

"FILLESA E QYTETIT NË VITIN 52, DHE LISTA E ATYRE QE DHANË DIÇKA NGA VETVETJA"
RASTESIA ËSHTE MBRETI I BOTES, KUJTIMI ËSHTE RESPEKT! (Mendim i lindur rastesisht)

Tani më shkoj ndermënd që ti përmëndi të gjithë, të paktën të Sektorit të Urbanistikës, sa të di e mundem me i kujtue, se respekti është për të gjithë, kushdo dhe kudo qe ka punue, më ndihmoni ju lutem, per t'i rikujtue.

RESPEKT E MIRENJOHJE PER:

Te pa harruerit që nuk jetojnë më: Ark. Piro Dilo, Ing. Dhurata Struga, Inxh. Musa Goçi, Ark. Hajdar Kovaçi, Inxh. Hasan Ponari, Inxh. Demush Malaj, Inxh. Agim Sula, Inxh. Klara Musaj, Tek. Ahmet Dega
Të palodhurit: Ark. Nexhmi Shtini, Inxh. Niko Jorgji, Ark. Nebi Nebiu, Inxh. Sabrie Logu, Ark. Hazir Isufaj, Inxh. Sadri Isufi, Ark. Artan Baliaj, Inxh. Mereme Breçani, Inxh. Riza Shpati, Top. Muhamet Katana, Top. Rifat Malaj, Tek. Hasime Memia, Tek. Tana Llukaj, Tek. Bedrie Isufi, Tek. Valentina Musaj, Tek. Mustaf Vatoci, Inxh. Egzon Muhametaj, e shumë e shumë të tjerë, që do i rikujtojmë përherë.
" Ta luftojme harresën"
Dhe meqë përmendem, krejt rastësisht, me aq sa na u kujtuan, kontribuesit në fushën e urbanistikës, nuk mund te rri pa përmendur edhe kontribuesit në fushën e ndërtimtarisë, lidhur me urbanistikën pazgjidhshmërisht.
Të paharruar do të mbeten në këtë fushë, të ndjerët:
Inxh. Sabaudin Xhafa, Inxh. Sokol Meshi, Inxh. Kol Brahaj, Tek. Shaban Doçi, Tek. Zog Hysenaj, Tek. Nikoll Isufi, Tek. Ali Rama, Tek. Esat Doçi, Tek. Çel Shabani, Tek. Gani Vidrica, Top. Beqir Gjoçaj, Top. Sherif Caka, Tek. Sali Breçani, Tek. Agim Çakrraj, Top. Ahmet Gabraj, Rifat Malaj, Musa Goçi, Sadri Isufi, Artan Baliaj, Hasan Ponari,etj.

Te respektuar përherë në kujtesën kolektive do të jenë: Inxh Alush Buçpapaj, Inxh. Prek Gjoka, Inxh. Agim Veshi, Inxh. Darvin Doraci, Inxh. Kujtim Bila, Inxh. Ilir Laska, Inxh. Ali Metaliaj, Inxh. Zeqir Matoshi, Inxh. Ramiz Kurtallari, Inxh. Zenel Koka, Inxh. Selim Haxhiaj, Inxh. Isa Gjongecaj, Inxh. Xhevdet Mulaj, Inxh. Mehill Qehaja, Inxh. Ali Haziri, Inxh, Mimoza Galanxhi, Inxh. Lulezim Rrahmani, Inxh. Feride Rrahmani, Inxh. Bukurie Doçi, Inxh. Dashnor Mustafaj, Inxh. Agim Dega, Inxh. Xhem Kojeli, Inxh. Sadri Buçpapaj, Inxh. Zanun Buçpapaj, Inxh. Agim Berisha, Inxh. Fatbardh Sokoli, Inxh. Rudina Logu, Inxh. Pare Vatnikaj, Inxh. Artan Zeneli, Inxh. Bardhok Alia, Tek. Ali Mulkurti,
Tek. Hasan Mehmeti, Tek. Dede Meshi, Tek. Xhavit Hysenaj, Tek. Sadik Bajrami, Tek. Mehill Gjoka, Tek. Sali Vidrica, Tek. Hajri Zhana, Tek. Zeqir Hyka, Tek. Ise Murati, Tek. Kade Balaj,

Tek. Shkelzen Logu, Tek. Ruke Aliaj, Tek. Zyra Shiqerukaj, Tek. Lush Neçaj, Tek. Marash Imeri, Tek. Prend Bushgjoka, Tek. Trashëgim Bardhi, Tek. Ismet Saraçini, Tek. Beqir Goçi, Tek. Prel Geci, Tek. Agim Doçi, Tek. Lek Gjonpali, Tek. Petrit Imeri, Tek. Bardhyl Vidrica, Tek. Kujtim Baliaj, Tek. Bajram Braha, Tek. Xhevat Mehmeti, Tek. Hysen Bisheva, Top. Medi Vladi, Tek. Shpresa Metaliaj, Tek. Gezim Jemishta, Tek. Agim Shabani, Top. Ramiz Sadiku, Tek. Zoje Ismailukaj, Tek. Sanie Byberi, Tek. Sabrie Gela, Tek. Flora Gjoka, Tek. Dede Kolbuçaj, Tek. Zef Bushgjokaj, Tek. Ndue Gjokli, Top. Ndue Susaj, Top. Lekë Bushati, Top. Kolë Hamza, Top. Gani Goçi, Top. Avni Rexhaj, Top. Lindita Prëngzaj, Top. Mustaf Gjoçaj, Top. Hamëz Shiqerukaj. Tek. Gjystina Vatoci, Tek. Bajram Hoxha, Tek. Avni Muja, Tek. Avdi Metaliaj, Tek. Gani Sokoli, Tek. Prek Hila, Top. Abdullah Pali, Top. Halil Demiri, Top. Xhafer Hysenaj, Top. Skender Memia, Top. Xheme Kurtsmajli, Tek. Hazir Brahimi, Tek. Zeq Aliaj , Tek. Hyrie Neza, Tek. Nushe Mustafaj, Tek. Ram Mehmeti, Tek. Qemal Avdia, Tek. Sabah Demushi, Tek. Sadik Gjoni, Tek. Shpresa Zalli. Tek. Violeta Gashi, Tek. Zoje Hoxha, Tek. Rushë Meshi, Tek. Kristina Meshi, Top. Bute Vakaj, Top. Ukë Kortoçi, Tek. Çaush Rexha, Tek. Mustaf Breçani, e të tjere .
Lavdi punës dhe veprës së tyre përherë !Këta duhet të shpallen të gjithë njëheri Qytetarë Nderi të këtij qyteti.
Duhet shtuar dhe pasuruar, nga ata që kanë materiale dhe dinë diçka edhe me emra, shënime dhe të dhëna të tjera, me autorë dhe objekte, unë po perpiqem, rastësisht me lindi ideja që ti lë të shkruar e arkivuar, për ti rikujtuar në breza.”

Arkitekt: Hazir Isufaj

Bajram Curri. Dhjetor 2021

Punet e Drejtorise se Planifikimit dhe Zhvillimit te Teritorit 2021

PROJEKTE TE REJA:

1. Rishikimi i Projektit e Preventivit të Rrugës Kam ~ Qafe Prushi.

2. Realizimi i Vlerësimit të objekteve në rrugën "Ram Sadria" për shpronësim në funksion te realizimit të objektit "Ndërtimi i Unazës së Qytetit B.Curri , Faza e II-te".

3. Ndjekja e ecurisë së Punimeve në 5 Segmentet Rrugore.

4. Ndjekja e ecurisë së Punimeve në Ujësjellësin e Dragobisë.

5. Ndjekja e ecurisë së Punimeve në Kanalizimet Valbonë.

6. Ndjekja e Punimeve në Rikonstruksionin e Stadiumit të Lojrave me dorë.
7. Hartimi i Projekt Preventivit e Specifikimet Teknike për Rrethimin e Stadiumit të Lojrave me dorë.

8. Rishikimi i Projekt – Preventivit e Specifikimet Teknike të Ujësjellësit Dushaj Epër.

9. Hartimi i Projekt – Preventivave për Rikonstruksionet e Urave Breçan, Lekbibaj, Astë, etj.

10. Hartimi i Analizave dhe Preventivave e Specifikimet Teknike për Mirëmbajtjen e Objekteve Ndërtimore.

11. Hartimi i Analizave dhe Preventivave e Specifikimet Teknike për Ndriçimin e Qytetit.

12. Hartimi i Analizave dhe Preventivave e Specifikimet Teknike për Ndriçimin e Rrugore B.Curri – Koçanaj.

13. Hartimi i Projekt Preventivit për Instalimin e Kamerave te Sigurise ne Qytetin e B.Currit.

14. Hartimi i Projekt Idesë dhe Preventivit për Rrugën Auto. Qafë Murrizi ~ Qafë Agri.

15. Hartimi i Projekt Idesë, Preventivit e Specifikimet Teknike për Rrugën Auto. Palç ~ Stacioni i Anijes (Liqeni i Komanit).

16. Hartimi i Projektit, Analizave dhe Preventivit e Specifikimet Teknike për Ndërtimin e Veprës së Marrjes (Tunelit), në kanalin e Gashit.

17. Hartimi i Projektit dhe Preventivit e Specifikimet Teknike për Ndërtimin e Veprës Marrjes per kanalin e Sopotit.
18. Hartimi i Projektit Arkitetonik dhe Preventivit për Adaptimin e godinave të Konviktit në Banesa Sociale.

19. Projekti për Sinjalistikën në qytetin e B.Currit.

20. Projekt ideja për Rrugën Markaj- Bishevë.

21. Zgjidhja e Problemeve për rrugët, Çelaj, Hysenukaj, Gurore e Shpatëz. (Hartimi i Skicave, preventivave, Projekt – Vendimet për Këshillin Bashkiak e tjerë për këto rrugë.

22. Bashkëpunimi me institucione te ndryshme dhe me shoqata per realizimin e Rikonstruksionit të 5 objekteve Arsimore në Bashkinë Tropojë.

23. Rakordimi i punes me APT- në e AZHT-në, për Rishikimin e PPV-së,së Bashkisë Tropojë.

24. Rakordimi i punës me EKB-në dhe fillimi i punimeve në Pallatin në Lagjen "Partizani".

APLIKIME PER FONDE:

Per 5 Objekte Arsimore, pranë USAID-it, dhe gjitha Institucioneve shtetërore dhe nuk kemi marrë përgjigje pozitive.Rruga Çerem, Rruga Luzhë, Rruga Qafë Prushi, Ujësjellësi Quk i Dunishës, Kolektori i Ujrave të Ndotura Qytet, Semaforët qytet, etj në FSHZH, nuk kemi marrë përgjigje pozitive.

LEJET E NDERTIMIT:

Gjatë këtij viti janë shqyrtuar 75 aplikime të qytetarëve në systemin e-leje, për leje zhvillimi, leje ndërtimi, çertifikata përdorimi, njoftime per fillim punimesh, shtyrje afati punimesh, deklrata paraprake, etj.
Nga këto jane miratuar 37 aplikime si më poshtë:

- ✓ 20 Leje Zhvillimi
- ✓ 30 Leje Ndërtimi
- ✓ 8 Leje infrastrukture
- ✓ 3 Çertifikata Perdorimi
- ✓ 6 Njoftime për fillim Punimesh
- ✓ 3 Shtyrje afati
- ✓ 5 Deklaratë paraprake

Janë miratuar:

- ✓ 10 Leje Zhvillimi
- ✓ 13 Leje Ndërtimi
- ✓ 6 Leje infrastrukture
- ✓ Çertifikata Përdorimi
- ✓ 4 Njoftime per fillim Punimesh
- ✓ Shtyrje afati
- ✓ Deklaratë paraprake

Janë në shqyrtim 26 kërkesa. Janë të përditshme takimet me qytetarët per problemet e ndryshme, si dhe kthim përgjigjet e rreth 450 shkresave, kerkesave dhe ankesave, të ardhura nga qytetarët dhe instutucionet.

Me respekt:
Ark. Hazir ISUFAJ
DREJTORIA E PZHT.



PËR PUNËN E ZHVILLUAR NGA SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE PËR VITIN 2021

Bazuar në Ligjin 57/2020 "Për Pyjet" , struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki është strukturë e specializuar në nivel vendor, me atribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor bashkiak në pronësi, në bashkinë Tropojë, kjo strukturë është e organizuar si sektor në Drejtorinë e Pyjeve ,Kullotave dhe Bujqësisë.
Sektori i Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Tropojë ka staf inxhiniero – teknik gjithsej 25 punonjës, të organizuar dhe të gatshëm për zbatimin e detyrave që ngarkon legjislacioni për pyjet, si dhe , " Planit të veprimit për pyjet dhe kullotat bashkiake" miratuar në KB Tropojë.

Janë hartuar, studime, programe–pune, për menaxhim-administrim të qëndrueshëm të fondit pyjor kullosor bashkiak, si dhe studimi dhe miratimi i mundësisë vjetore të shfrytëzimit për vitin pyjor nëpërmjet ndërhyrjeve rigjeneruese e shëndetësore për pyjet në pronësi të bashkisë Tropojë , me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje për institucionet dhe popullatën . Duke i shërbyer mbrojtjes dhe rigjenerimit të pyjeve, duke hequr drurët e dëmtuar nga faktorë natyrorë si dhe për të tejkaluar moshën e shfrytëzueshmërisë dhe për ti dhënë prioritet filizërisë Njëkohësisht duke siguruar të ardhura për bashkinë,theksojmë se kemi realizuar mbi 80 % të planit të të ardhurave për vitin 2021.

Gjate punës për evidentimin e dëmtimeve nga shkaqet natyrore (Zona Lekbibaj).

Plani i masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga veprimtaritë e paligjshme, i hartuar pas takimeve të organizuara nga përfaqësuesit e bashkisë, policisë së rendit, kryetarë fshatrash, drejtorë shkollash, në çdo Njësi Administrative ka dhënë rezultate të larta në minimizimin e prerjeve të paligjshme në pyje, ndërhyrjeve të paligjshme në fond pyjor – kullosor, në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabis-it , duke informuar dhe ndërhyrë në kohë reale për parandalimin e tyre.

Ne Njesine Administrative Bujan

Ne Njesine Administrative Fierzë

Programi i punës për parandalimin dhe masat e marra për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri është hartuar duke bërë kordinimin e punës ndërmjet institucioneve, personelit pyjor-njësi administrative-kryetar fshatrash-emergjencat civile -polici rendi-vullnetar, për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret.

Me ngritjen e skuadrave vullnetare të MNZSH-së, përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare, informimin e publikut, kontrolle operative, trajnimet e personelit, dhe sinjalizimin në kohë reale të rasteve kemi arritur të minimizojmë rastet dhe dëmet e shkaktuara nga zjarret. Situata tepër kritike që ka karakterizuar periudhën e zjarreve në gjithë vendin ka qenë problem dhe për bashkinë tonë, por vlerësimi dhe informimi në kohë reale ka bërë që të kemi dëm ekonomik nga rastet e zjarrit në vlera minimale.

Kemi patur gjithsej 11 raste zjarresh përgjithësisht sipërfaqësorë, dhe vetëm një rast ku ka qenë shumë e vështirë ndërhyrja për shkak të terrenit tejet shkëmbor (mbi bjeshkët e Bëtoshës) që ka rezultuar me djegie sipërfaqe pyjore 6 ha.

Momente gjatë punës për shuarjen e zjarreve në sipërfaqet pyjore.

Bashkia Tropojë gjatë vitit 2021 ka bërë azhornimin e listës së inventarit të fondit pyjor kullosor për ndryshimin në VKM nr.433 dhe përmbylljen e proçesit të regjistrimit të pyjeve dhe kullotave bashkiake në kuadër të projektit të Regjistrimit Fillestar Të Pasurive të Tipit Pyje dhe Kullota , sipas fazave në shërbim të këtij proçesi dhe nuk ka rezultuar të ketë kundërshtime ose dokumenta që fermerë apo përdorues pyjesh të rezultojnë se kanë dokumenta pronësie për këto sipërfaqe pyje, kullota dhe gështenjë.
Sipërfaqet e pyjeve të gështenjës me një sipërfaqe rreth 2000 ha kanë rezultuar informale, dhe me një proçes të iniciuar dhe realizuar me iniciativën e kryetarit të bashkisë z.Rexh Byberi dhe të instancave më të larta është bërë e mundur që të formalizohen pra të shtohen në rregjistrin e pyjeve dhe kullotave me VKM nr. 134, datë 3.3.2021"Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433 datë 8.6.2016."

Nisur nga sa më sipër janë kaluar të gjitha etapat e proçesit të rregjistrimit dhe jemi në pritje të akteve nënligjore të Ligit nr. 57/2020 "Për pyjet" që sipërfaqet pyjore – kullosore tju jepen fermerëve/përdoruesve sipas VKM-ve, urdhërave dhe udhëzimeve .

Afishimi i siperfaqeve te geshtenjes ne Njesite Administrative

Gjatë vitit 2021, sektori i Pyjeve dhe Kullotave është angazhuar në çdo nismë të marrë për ti shërbyer njedisit. Në objektin e pyllëzimit përgjatë akseve rrugore janë kryer shërbime kujdesimi dhe zëvendësimi sipas nevojës.

Per Mjedis te paster

SEKTORI I UJITJES:

Mbi punën e kryer nga sektori i ujitjes Bashkia Tropoje per venjen në punë të objekteve ujitëse për vitin 2021, dhe konkretisht:

I. Njësia Administrative Margegaj
II. Njësia Administrative Bujan

Kanali Ujitës i Krasniqes:
Ka një gjatësi 12 km.Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër te k/bashkise për evidentimin dhe vlerësimin e dëmtimeve gjatë sezonit të dimrit është bërë vlerësimi dhe janë angazhuar punëtorët e shërbimeve për gërmimet dhe pastrimet në pjesën me të madhe të gjatësisë të kanalit,punime të cilat janë kryer brenda afateve Ujitja në këtë objekt funksionon në gjithë gjatësinë duke përfshirë dy njesitë administrative Margegaj dhe Bujan.Çdo punim është i evidentuar dhe matur në prezencë të komisionit.

- Janë kryer pastrimet në një gjatësi 8984 ml ,
- Janë siguruar dhe vendosur dërrasat për presat,
- Eshte siguruar plasmasi për te vepra e marrjes dhe presat.

Ky objekt është vënë në punë për vaditje brenda sezonit ujitjes. Krahas punimeve operative është punuar dhe në vepra arti siç është ndërtimi i kanalit në pjesën fundore Lagjia Dozhlan, duke zgjidhur përfundimisht furnizimin me ujë duke përfshire lagjet Vatoc,Vidricë dhe Dozhlan:

Eshte zhbllokuar sifoni i Shudenicës i bllokuar nga materiale, (plasmas dhe mbeturina), duke mos ndërprerë ujitjen në asnjë moment.

Njësia Administrative Tropojë:

Kanali ujitës i Gashit:

Në bazë të grupit të punës ngritur me urdhër të k/bashkisë janë bërë matjet dhe evidentuar dëmtimet në gjithë gjatësinë e kanalit dhe konkretisht:

- ✓ Është ndërtuar ama (vepra e marrjes),plasmas,thaset, rërë,gozhda,tel...
- ✓ Eshte punuar dhe vendosur në zonën e shëmjes, mal rrafsh me gjatësi 60 ml tubacion % 50 cm (dy tuba krahas)
- ✓ Janë realizuar gërmimet me eskavator në Drejtovë.
- ✓ Është vendosur në zonën e shëmjes afër kabinës elektrike ,18 ml tub % 80 cm.
- ✓ Furrnizim me dërrasa për presa.

Kanali i GASHIT – (Shëmja në Mal Rrafsh)

Kanali i GASHIT(Drejtovë, te kabina)

Kanali Tabak – Mejdan - (gjëndja përpara punimeve)
U bë e mundur me ndërhyrjen e kryetarit të Bashkisë në këtë kanal të lënë shumë vite mbas dore dhe të vihej në punë për ujitjen e dhjetra hektarë tokë.

Angazhimi i gjithë sektorit për ujitjen është maksimal me detyra të përcaktuara.

Punoi:Xhavit Çela
Miratoi:Kujtim Baliaj

ZYRA E INTEGRIMIT EUROPIAN :

Zyra e Integrimit Evropian Tropojë pas një pune dy vjeçare në kuadër të Programit IPA II të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi, bëri të mundur në janar finalizimin dhe nënshkrimin e një marrëveshje të rëndësishme e efikase mes Bashkisë Tropojë dhe Komunës së Plavës, e cila u firmos nga kryetarët respektivë, Rexhë Byberi dhe Nihat Canoviç.
Ky projekt i cili do investohet dhe implentohet në qytetin Bajram Curri ka të bëjë me grumbullimin dhe përpunimin e bimëve medicinale të cilat janë një aset i rëndësishëm i kësaj treve.

Nga shpallja fitues të aplikimit të Zyrës së Integrimit Evropian në skemën e granteve Japoneze "Grant Assistance for Grass-roots Human Security Projects" (GGP), u bë e mundur në mars 2021 që Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Ambasadori i Qeverisë Japoneze në Shqipëri të firmosin Kontratën e Grantit të dhuruar nga Qeveria Japoneze. Ky është një Grant i konsiderueshëm, 81 000 euro, që parashikon dhënien e makinerive moderne për pastrimin e qytetit.

"Të dhurojmë kujdes e dashuri aty ku është më e nevojshme dhe njerëzore": Në Ditën Botërore të Autizmit, Zyra e Integrimit Evropian në bashkëpunim me sektorin e Mbrojtjes Sociale pranë Bashkisë Tropojë, Shoqatat "Integrimi" dhe "Bashkësia Biblike" organizuan një aktivitet sensibilizues për vëmendje profesionale dhe humane ndaj kësaj kategorie. U shpërndanë dhurata simbolike të cilat jo vetëm u mirëpriten nga fëmijët autikë por zgjuan tek të gjithë një ndjeshmëri e solidaliritet aq të nevojshëm dhe për kohën e vështirë që po jetojmë.
Ky është jo vetëm akt humanizmi por obligim që së pari tregon civilizim dhe evropianizim!

Për dy ditë radhazi, 9 dhe 10 maj, Zyra e Integrimit Evropian dhe Bashkia Tropojë patëm privilegjin të ishim mikpritës të Ambasadorit të BE-së në Shqipëri Sh.T.Luigi Soreca i cili shoqërohej nga Ambasadorët e Francës, Austrisë, Spanjës si dhe stafet e tyre diplomatike. Ata nisën udhëtimin me autobusin e tyre "Evropa është këtu" në qytetin e Bajram Currit ku nëpërmjet një sërë aktivitetesh u festua dhe Dita e Evropës. Ambasadorët theksuan në takimet e aktivitetet e shumta publike dhe zyrtare gjatë këtyre dy ditëve se Tropoja është përzgjedhur për të dhënë mesazhin e qartë se e ardhmja jonë edhe në skajet e vendit është Evropa. U diskutua për investime strategjike në zonën tonë për t'i dhënë një hop cilësor e bashkëkohor zhvillimit të turizmit,

bashkëpunimit ndërkufitarë si dhe shfrytëzimit racional të resurseve tona të shumta natyrore. Ambasadori Soreca pranoi me emocion të veçantë titullin "Mirënjohja e Tropojës" akorduar nga Kryetari me rastin e kësaj vizite historike në një moment të veçantë të Integrimit Evropian të vendit tonë.

Në shtator 2021, u iniciua Konsortiumi Pushtet Vendor – Shoqëri Civile për Vullnetarizëm të Qëndrueshëm Lokal.

Kjo iniciativë është një risi dhe ka si qëllim nxitjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet pushtetit lokal dhe shoqërisë civile për të krijuar një terren të përshtatshem dhe të qëndrueshëm për nxitjen dhe praktikimin e vullnetarizmit në pushtetin vendor. Ishte Zyra e Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj që ndërmjetësoi këtë proçes dhe nxiti bashkëpunimin mes Bashkisë Tropojë dhe Organizatës “Projekte Vullnetare Ndërkombëtare (PVN)”, Organizatës Ndërkombëtare “Service Civil International (SCI)”, dhe Kongresi Rinor Kombëtar (KKR). Ky është fillimi i një rruge të gjatë, strategjike dhe të qëndrueshme që synohet të ndërtohet bazuar në rëndësinë e bashkëpunimeve pozitive.

QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE :

Qendra Kulturore e Fëmijëve, si institucion arsimor plotësues ka realizur veprimtari te larmishme për data, ngjarje dhe evente të rëndësishme për vitin 2021.

1. Kënga e Gjyshes, 27.01.2021.
2. Kënga Margjelo ,04.02.2021
3. Pavarësia e Kosovës ,17.02.2021
4. Festat e 7-8 Marsit 2021.
5. Kënga" Pranvera filloj me ardhë" ,14.03.2021.
6. Ekspozitë nga Alba Lataj ,19.03.2021.
7. Këngë për Bajram Currin ,29.03.2021.
8. Dita e Tokës, 22.04.2021
9. 5-Maji Dita e Dëshmorëve 2021
10. Dita e Evropës, 09.05.2021.
11. 1-Qershori 2021
12. Sofra Dardane ,11.06.2021
13. Pjesëmarrja në Kampin Veror ,21 deri me 30 Korrik 2021
14. Konferenca e Veteranëve, 14.10.2021
15. Përgatitja për Festivalin 2-të Mbarëkombëtar të këngës për fëmijë ,17.10.2021
16. Tetori Muaji Letersisë 2021
17. Festa e Gështenjës ,30.10.2021
18. Dita ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve, 20 Nëntor 2021
19. Festat e Nëntorit 2021
20. Ndezja e Dritave në Qytet, në prag të Festave, 15.12.2021
21. Festat e Fundvitit 2021

CHILD RIGHTS

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Sektori i Burimeve Njerëzore kanë bërë një punë mjaft të mirë në trajnimin dhe aftësimin profesional të punonjësve, duke përfshirë pjesëmarrjen në trajnime dhe seminare të mbajtura nga profesionistë të fushave dhe institucione trajnimi në mënyrë që të ketë një staf të kualifikuar që ofron shërbime cilësore për qytetarët .
Një ndër risitë që ka sjellë drejtuesi i institucionit,Kryetari i Bashkisë Z.Rexhë Byberi është edhe punësimi dhe promovimi i të rinjve në Administratën e Bashkisë Tropojë. Që me ardhjen në këtë detyrë numri i të rinjve të punësuar pranë Bashkisë Tropojë është rritur ndjeshëm, duke përfshirë shumë prej tyre dhe në role drejtuese .Prioritet është që kjo përfshirje të jetë edhe më e lartë. Gjatë kësaj periudhe të gjithë studentëve që kanë qenë të interesuar ju është dhënë mundësia për të kryer praktikën profesionale pranë Bashkisë Tropojë. Pandemia nuk ka qenë pengesë për zhvillimin normal të punës dhe ofrimin e shërbimit me profesionalizëm te qytetarët.

INSPEKTORIATI I MBROJTJES SE TERRITORIT:

Puna e IMT-së gjatë vitit 2021:

Baza ligjore e sektorit të IMT-së gjatë punës kanë qënë urdhërat e udhëzimet detyrat e caktuara nga Institucioni i Bashkisë Tropojë,IKMT Kukës dhe IKMT Tiranë ,mbështetur në nenin 12 Pika b/a të ligjit nr 9780 datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundraligjshme i ndryshuar në pikën 5/c të VKM-së nr 894 datë 04.11.2018 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtarë i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore.

IMT-ja e Bashkisë Tropojë ka ndjekur procedurat standarte në procesin e punës duke ju referuar planeve të punës mujore ,inspektimeve në terren, organizimin e punës dhe bashkëveprimin me strukturat e njësive vendore ,kryetarët e fshatrave si dhe bashkëpunimi me Policinë e Shtetit. Për evidentimin e situatës në terren për kostatimin ,pezullimin e vendimin e prishjes si dhe vendimin e gjobave për subjektet e kundraligjshme .
Në procedurat standarte te IMT-së janë ndjekur dhe zhvilluar këto kostatime vendime gjobash dhe vendime prishje .

Procesverbal kostatimi kundravajtje 23
Vendim pezullimi 21
Vendim gjobash 17
Vendime për prishje 12 të objekteve pa leje ndërtimi.
Janë ndjekur të gjitha procedurat për informimin e IKMT-së Kukës dhe IKMT-së Tiranë.
Është mbajtur e gjithë procedura korrekte me subjektet private dhe fizikedhe qytetarët në trajtimin e procedurave ligjore.

Inspektore IMT-së:
Nafie REXHA

VEPRIMTARIA E KËSHILLIT BASHKIAK:

Vazhdimisht Këshilli bashkiak Tropojë gjendet aktiv në përfshirjen e tij në zgjidhjen e problemeve që paraqesin qytetarët si dhe me një vendimmarrje transparente ndaj publikut dhe gjithmonë në respekt të ligjit për funksionimin e qeverisjes vendore dhe në raport të komunikimit adekuat me ata që i kanë zgjedhur. Pjesë e Projektit "Bashkitë e forta "dhe i listuar në dhjetë këshillat bashkiakë model në Shqipëri, çdo ditë dhe më shumë ai po shndrrohet në zëdhënësin e çmuar të qytetarëve përballë pushtetit vendor.

Jane shpallur qytetar Nderi gjatë vitit 2021:

Halil Ahmeti, Filip Çakulli, Shefqet Sadiku, Granit Nezaj, Mustaf Sali Memia, Beqir Rexhmati, Dedë Mala, Shkelzen Zalli, Agron Geca, Gentjan Demaliaj, Rrustem Shehu, Byber Byberi.

Janë emëruar:

Stadiumi i lojrave me dorë emëruar me emrin Bajram Mal Gjongecaj.

Janë emëruar rrugët:

Fierzë- Lekbibaj , me emrin "Sokol Meshi".

Astë- Muhejan, me emrin "Ali Rrustemi".

Buçaj –Papaj, me emrin "Ruga e lirisë".

Markaj -Kodër Markaj , me emrin "Ali Zeneli".

Miratuar në parim:

Projekti i rrugës Markaj-Bishevë.

Tropojë- Sylbicë.

Kanali i Gashit.

Qafë Agri -Qafë Murriz.

Stacioni anijes Palç- Guri i Lules.

Fondi për rrethimin e stadiumit të lojrave me dorë.

Programi i transparencës së bashkisë

Janë ndihmuar:

14 familje nga fondi i emërgjencës civile për raste të fatkeqësise natyrore dhe rreth 18 familje në rast vështirësie ekonomike dhe raste sëmundjesh.

BASHKIA TROPOJE

BASHKIA TROPOJE

BASHKIA TROPOJE

BASHKIA TROPOJE

SEKTORI ZJARRFIKËS :

Sektori zjarrfikës i bashkisë Tropojë gjatë vitit 2021, nën drejtimin e kryeinspektor Fatmir Rexhaj ka punuar dhe ka qëndruar në gatishmëri për tju pergjigjur në kohë dhe me profesionalizëm çdo situate zjarri te krjuar në territorin e Bashkisë Tropojë. Stërvitja e vazhdueshme dhe kompletimi me efektv sipas kritereve ka bërë që ky sektor të minimizojë në maksimum dëmet e shkaktuara nga zjarri në objekte, pyje e kullota. Gjatë këtij viti në territorin e Bashkisë Tropojë kemi pasur 67 raste të rënies së zjarrit dhe në të gjitha këto raste ndërhyja e shërbimit zjarrfikës ka qënë e menjëhershme ,duke bërë të mundur fikjen e zjarrit dhe zvoglimin e dëmeve .Ky sektor vazhdon traditën për bashkëpunim të mirë me brigatën e zjarrfiksave Gjakovë, për ndihmë të ndërsjelltë dhe fikjen e zjarreve gjatë e vijës kufitare Tropojë-Gjakovë.

VEPRIMTARIA E QKB-së:

Përmbledhësja e veprimeve të kryera ne Sportelin QKB pranë Bashkisë Tropojë për Vitin 2021 është kjo:

- ✓ Regjistrime Fillestare 25
- ✓ Aktivizime 47
- ✓ Pezullime 52
- ✓ Ndryshime 250
- ✓ Regjistrime ne Portal E-Albania 700

Përveç këtyre shumë e shpeshtë ka qenë ndihma që u kemi dhënë çdo qytetari që na ka kërkuar ndihmë për regjistrime tek Portali E-Albania, për vertetimet e ndryshme ,që ju jane kërkuar nga institucionet e tjera te ky Portal. Kemi parim kryesor mirësjelljen dhe respektin ndaj çdo qytetari ,i cili paraqitet pranë Sportelit QKB Tropojë

Fatmira Memia

Majlinda Çakraj




PRITJE E QYTETARËVE
OKB
OKB

ROLI DHE VEPRIMTARIA E POLICISË BASHKIAKE:



POLICIA BASHKIAKE

Policia bashkiake gjatë vitit 2021,në vijimësi është e angazhuar për të zbatuar sa më mirë detyrat që i ngarkon ligji nr.8224,datë 15.05.1997 për Organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë,vendimet e këshillit bashkiak si dhe aktet dhe urdhërat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë.

Puna e deritanishme në përgjithësi ka qenë rezultative dhe roli i kësaj policie,si forcë ekzekutive në ndihmë të ushtrimit të funksioneve të organeve dhe strukturave të Bashkisë,është i rëndësishëm.

PUNA E POLICISE BASHKIAKE TROPOJË PËR VITIN 2021 KISHTE KËTO OBJEKTIVA:

- Në zbatimin e akteve ligjore e n/ligjore ,Vendimet e këshillit Bashkiak,akteve, urdhërave dhe detyrave të dhëna nga Kryetari i Bashkisë.
- Rritja e përformancës në punë ,etikës së komunikimit me komunitetin e me gjerë,ne zbatimin me rigoriozitet të detyrave të planizuara ditore ,javore e mujore.
- Në kontrollin e vazhdueshem të territorit,për të mos lejuar shkeljet ligjore për zënjen e hapësirave publike,apo tregëti e paligjshme (ambulantët), vendosjen e reklamave,tendave,dëmtimin e sipërfaqeve të gjelbra,trotuareve,ndriçimit publik,ndotjen e mjedisit,hedhjen e mbeturinave,inerteve si dhe ndëshkimin e kundravajtësve me gjobë.
- Në parandalimin,pezullimin dhe prishjen e ndërtimeve pa leje, duke e mbështetur IMT e bashkisë në zbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje,objekte që pengojnë punimet në infrastrukturën rrugore,ndërtime pa leje në fasada,shkallë,mure rrethuese etj.
- Në bashkëpunimin e ngushtë me zyrën e tatim taksave, për taksa, tarifa vendore nga subjekte juridike e fizike, që nuk kanë respektuar afatet ligjore apo nuk janë rregjistruar fare si subjekte.Për këtë në zbatim të urdhërit të kryetarit të bashkisë policia bashkiake është e angazhuar për të mbështetur inspektorët e zyrës së tatim taksave,për mbledhjen e të ardhurave,debitorët si dhe taksën e biznesit të vogël, duke detyruar të gjitha subjektet juridike dhe fizike, që ti shlyejnë detyrimet e Bashkisë Tropojë.
- Duke qenë organ ekzekutiv,policia bashkiake ka zbatuar urdhërat administrativë të kryetarit të Bashkisë për lirimin e objekteve që janë pronë e Bashkisë,për lirimin e hapësirave publike,rrugëve.prishjen e objekteve pa leje dhe do të jetë rigoroze në zbatimin e urdhërave të kryetarit gjatë gjithë vitit.
- Policia bashkiake do të marrë masa për sigurimin e parkingjeve, duke i orientuer drejtuesit e mjeteve për parkingjet e miratuara,njëkohësisht ka marrë e do marrin masa për kontrollin e parkingut të bashkisë,kontrollit te Pedonalja,zbatimin e rregullit për furnizimin e subjektve,që kanë autorizim,po kështu do të ndikojë në disiplinimin e mjeteve të transportit të udhëtarëve,në linjat ndërqytetare dhe ato të brëndshme,ku kontrolli do të insistojë në paisjen me licenca ,dokumentacion ,zbatimin e vendparkingjeve ,të orareve,duke bashkëpunuar me policinë rrugore.
- Në marrjen,ndjekjen e zgjidhjen e kërkesë- ankesave të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme shtetërore e private,të sjella nga protokolli, telefonatat gjatë kësaj periudhe ka patur ankesa nga qytetarët për prishje qetësie publike nga subjekte të ndryshme në lokale gjatë natës,është ndërhyrë në bashkëpunim me policinë e shtetit dhe grupet e gatshme për stabilizimin e situatës.

Gjatë vitit do të ketë nje bashkëpunim më të ngushtë me sektorin e emergjencave,nisur nga fakti sepse është një detyrim ligjor për Policinë Bashkiake.

Policia bashkiake në bashkëpunim me Policinë e Shtetit IKSH –në Tropojë dhe sektorë të tjerë ka ndihmuar në marrjen e masave për zbatimin e urdhërave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetit Publik për Covid 19, duke bërë inspektime të vazhdueshme për respektimin e rregullave ,akteve ligjore e normative,të miratuara nga Parlamenti e Qeveria.

Disa nga objektivat e Policisë Bashkiake rrjedhin nga detyrat kryesore siç janë:

- Të sigurojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë, vendimet e këshillit bashkiak që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve publike.
- Të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së Bashkisë ,Njësive Administrative si dhe atyre që administrohen prej tyre.
- Të sigurojë zbatimin e urdhërave të nxjerra nga kryetari i Bashkisë ,në lidhje me personat juridikë,që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale ndaj Bashkisë ,Nj. Administrative si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre.
- Të mbikqyrë e verifikojë nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojne kërkesat e akteve bashkiake.
- Të mbikqyrë dhe të marrë masa ndaj shtetasve ,subjekteve fizike e juridike,kur konstaton shkelje të rregullave për hedhjen,grumbullimin,largimin dhe përpunimin e mbeturinave dhe për mbrojtjen e mjediseve publike.
- Të kontrollojë,bllokojë,pezullojë dhe prishë ndërtimet e paligjshme në bashkëpunim me IMT-në e Bashkisë.
- Të bashkëpunojë me Policinë e shtetit për sigurinë e rendit dhe të qetësisë,zhvillimin e aktiviteteve kulturo- artistike e sportive në territorin e Bashkisë.

Policia bashkiake ka ndihmuar rast pas rasti dhe ju ka ardhur në ndihmë pjesëtarëve të komunitetit për raste nevojash e fatkeqësish,duke zbatuar rregullat e procedurat ligjore .Gjithashtu ka qenë prezente në trajtimin e problematikave jo vetëm në qytet , por edhe në zonat rurale,në bashkëpunim me sektorët e tjerë

Për Policinë Bashkiake:

Besjan Sylaj

Punonjësit e Policisë Bashkiake:

1-Besjan Sylaj (përgjegjës)

2-Avni Malaj (punonjës)

3-Petrit Memia (punonjës)

4-Arben Byberi (punonjës)

5-Sokol Memia (punonjës)

DREJTORIA EKONOMIKE

Është privilegj, nder, arritje për ne si Drejtori Ekonomike të jemi pjesë e një qeverisjeje të tillë vendore ku profesionalizmi i punës, përbërja e një stafi bashkëkohor dhe të aftë është një ndër strategjitë kryesore të saj.

Drejtoria Ekonomike deri tani ka zbatuar politikat shtetërore në procesin e menaxhimit të ceshtjeve financiare në përputhje me politikat dhe procedurat ligjore, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuara të institucionit.

Një nga pikat kryesore të punës tonë eshtë buxheti dhe alokimi i burimeve ekonomike ku në themel të cdo projekti qëndron nevoja e qytetare. Është shumë e rëndësishme që cdo vendim që merret në lidhje me drejtorinë tonë nga Këshilli Bashkiak të jetë transparent dhe për cdo qytetar.

Procedurat e prokurimit te realizuara per vitin 2021

Nr.	Objekti i Prokurimit	Vlera e kontratës pa TVSH	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Data e njoftim fituesit
1	Mirembajtje rruga Markaj lagja brecani + zenelaj (+rruga rurale)	724,172.00	VLLAZNIMI	14.10.2021
2	Blerje materiale ndertimore	689,000.00	Kadri Buçpapaj	10.03.2021
3	Blerje dyshek dhe batanie per	93,600.00	Përparim Agimi	28.10.2021
4	Rikonstruksion I Kanalit Krasniqes	645,000.00	HTSH	23.06.2021
5	Blerje kamioni	6,360,000.00	TIMAC	16.08.2021
6	Blerje karrike dhe tavolina	582,000.00	Kadri Buçpapaj	13.09.2021
7	Blerje kondicionere	166,000.00	Platon Koxha	05.11.2021
8	Riparim ure Beli	380,000.00	4 A CONSTRUKSION	19.08.2021
9	Furnizim dhe vendosje te materialeve dekorative per festat e	228,900.00	Malvina Visoka	07.12.2021
10	Blerje materiale /dezinfektim	249,080.00	Malvina Visoka	06.07.2021
11	Sherbim per mirembajtjen e makinave	778,400.00	Adriatik Sallahu	03.08.2021
12	Blerje stufa drush tuba brryla per shkollat kopshtet cerdhet	250,000.00	Kadri Buçpapaj	12.11.2021
13	Blerje tubacione per Kanalin e Gashit pjesa II	749,000.00	TRAJLER	03.06.2021
14	Blerje materiale zyre	150,000.00	InfoSoft Office	05.07.2021
15	Kanal i ujrave te larta lagja Zelaj	713,000.00	TRAJLER	23.11.2021
16	Blerje Kancelari	133,333.00	LIBRARI DYRRAHU	22.06.2021
17	Materiale pastrimi per shkollat	218,900.00	Malvina Visoka	02.09.2021
18	Blerje orendi paisje zyre	382,000.00		10.03.2021
19	Sherbim mirembajtje makinash	630,000.00	Adriatik Sallahu	12.05.2021
20	Mirembajtje rruge per vitin 2021-	960,872.00	TRAJLER	22.09.2021
21	Rikonstruksion rruga Salce-Brice km 2060-2970	797,000.00	HTSH	30.09.2021
22	Ndertim Rruga Salce-Brice	656,500.00	HTSH	16.06.2021
23	Sherbim interneti	410,000.00	IH-NETWORK	28.04.2021
24	Sherbim makina	745,010.00	Adriatik Sallahu	04.11.2021
25	Sherbim fadrome	750,000.00	SERDADO	11.11.2021
26	Aktiviteti Sylbice	369,420.00	Hire Hajdarmataj Hajdarmataj	04.08.2021
27	Rikonstruksion Kanali Ujites I Gashit viti 2021	398,000.00	TRAJLER	24.05.2021
28	Blerje printera laptop mouse	148,000.00	Kadri Buçpapaj	10.03.2021
29	Hapja e sezonit turistik Valbona	498,320.00	NAZMI MURATAJ	10.06.2021
30	Transport i materilae per Kanali i Gashit pjesa III	798,500.00	TRAJLER	27.05.2021
31	Akomodimi I hotelit per ekipin Valbona	792,000.00	VLLAZNIMI	31.08.2021
32	Supervizori I mirembajtje rruge	79,666.00	2-RSH	12.02.2021
33	Blerje karburant	8,000,000.00	Kastrati	16.03.2021
34	Kolaudim mirembajtje rruge 2020	8,100.00	M.A.K Studio	25.02.2021
35	Kolaudim I varrezave	6,510.00	M.A.K Studio	25.02.2021
36	Blerje materiale pastrimi	163,000.00	Nirupa	05.03.2021
37	Blerje bojra per fotokopje dhe printera	159,500.00	Blueprint Techologies	09.03.2021
38	Blerje artikuj ushqimore	798,800.00	NAZMI MURATAJ	10.05.2021
39	Mirembajtje objektesh ndertimore	4,443,910.00	Kadri Buçpapaj	07.06.2021
40	Kolaudim I ujesjellesist te fshatit Dragobi	183,667.00	2-RSH	02.07.2021
41	Dru zjarri	5,398,785.00	NAZMI MURATAJ	27.08.2021
42	Festa e geshtenjes	285,890.00	Tefik Kurti	29.10.2021
43	Rikualifikimi urban Lagja Pratizani blloku 1&2	60,338,235.00	proces (fondi limit)	
44	Blerje karburant (nafte)	836,000.00	Kastrati	24.11.2021
45	Blerje vegla pune	700,000.00	Kadri Buçpapaj	13.12.2021
46	Rrethimi dekorativ I stadiumit te lojrave me dore	3,335,385.00	proces (fondi limit)	
47	Asaltim mbushje gropash viti2021	924,500.00	HB-Groupconstuction	06.12.2021
48	Rikonstruksioni I Rrjetit te ndricimit rrugor Margegaj-Kocanaj	785,000.00	VLLAZNIMI	15.12.2021
49	Ndertim ujesjellesi Dushaj Eperm (faza II)	999,000.00	VLLAZNIMI	29.12.2021
	Vlera totale pa TVSH	108,891,955.00		

SEKTORI I TATIM TAKSAVE NË BASHKI

Informim mbi punën e bërë në afatin kohor prej Janari -Nëntor 2021:

Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore ka peshën më të madhe të përgjegjësive dhe të detyrave ndaj banorëve të Malësisë së Gjakovës, sepse të gjitha të ardhurat e arkëtuara rezultojnë si rrjedhojë e pagesës së bizneseve dhe shërbimeve, që ofrohen nga Bashkia Tropojë.

Stafi i specialistëve ka dhënë përpjekjet maksimale nga ana e tij për realizimin e planit, për këtë flet fakti që tregon për tejkalimin e realizmit të të ardhurave, të ndara këto në zëra specifike, si me poshtë vijon:

- Të ardhurat nga taksat vendore: tatimi mbi të ardhurat personale, tatami i thjeshtuar mbi fitimin, nga taksa mbi pasurine e paluajtshme etj.
- Të ardhurat nga tarifat vendore: tarifat e shërbimeve, tarifat e shërbimit administrative.
- Gjobat.
- Të ardhura jotatimore.

Realizimi i planit per 11 mujorin e vitit 2021 është në masën 119.2%, pra tregues i faktit të tejkalimit të planit dhe të një përformance të lartë të stafit të specialistëve. U është dhënë përgjigje shkresave zyrtare dhe kërkesave të bizinesit për cdo paqartesi nga ana e tyre. Në arketimin e debitorëve është bërë një punë e rëndësishme.Ky sektor tregon një shërbim të veçantë në shërbimin e taksapaguesve dhe të qytetarëve.

Përsa i takon punës së terrenit nga specialistët përkatës, është bërë një punë informuese për bizneset, të cilët janë sqaruar edhe për masat administrative, në rast të mosregjistrimit te tyre dhe pajisjes me NIPT. Janë regjistruar biznese të rinj si edhe i është kushtuar rëndësi vjeljes së taksës së hoteleve në zona turistike.

Për licensimet, certifikatat dhe autorizimet për vitin 2021 janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për mjetet e transportit të mallrave për të tretë dhe me qera. U është bërë njoftimi zyrtar për rinovimin e licensave me afat të përcaktuar. Sektori i ndërtimeve, në sistemin e-leje, ka bërë arkëtime si pjesë e taksës së infrastrukturës dhe kjo ka ndikuar ndjeshëm në realizimin e planit të të ardhurave për vitin 2021.

Kemi premisë për bashkëpunim me DRT Kukës dhe me çdo institucion i cili, mundëson mbarëvajtjen e punës që lidhet me sektorin tonë.




COPËZA NGA DITARI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT TË BASHKISË

JANAR 2021:

Përkujdesje e veçantë e qeverisë shqiptare dhe personalisht e kryeministrit z. Edi Rama ndaj Tropojës, kthimi i plotë i vemendjes dhe përkushtimit ndaj zhvillimit dhe përparimit të saj si dhe adresimit të fondeve në ndihmë të promovimit të turizmit, rrugëve të reja si dhe mbështetjes ndaj fermerëve në zonat rurale.

Moti i ashpër që ka mbërthyer vendin tonë prej disa ditësh ka bërë të hasim në jo pak problematika, por gadishmëria, dhe shërbimi i shtabit të emergjencave civile pranë Bashkisë Tropojë nuk kanë reshtur ditën, as natën dhe janë gjendur pranë komunitetit në të gjitha njësitë administrative.

Sot Valbona është një destinacion gjithnjë e më i kërkuar, ku falë rrugës së re e bujtinave që shtohen njëra pas tjetrës, po hapet hap pas hapi perspektiva e re e ekonomisë së turizmit malor.

22 Janar:

Sot në Shkodër së bashku me kryetarin e komunës së Plavës Z. Nihat Canoviç nënshkruam marrëveshjen ndërkufitare për bimët medicinalë.

05 SHKURT: Filluan punimet për rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugëve të brendshme të Cërrnicës.

Në asnjë kohë, nuk jam i lirë dhe as njoh ditë pushimi kur bëhet fjalë për shërbimin ndaj Tropojës dhe komunitetit të saj, dhe kjo jo vetëm për mua, por për gjithë administratën e bashkisë dhe çdo person tjetër që ka përgjegjësi dhe detyrim për punë.

Moti i mirë këto ditë ka favorizuar dhe menjëherë kanë nisur dhe punimët për rikonstruksionin dhe asfaltimin e rrugës Astë-Myhejan-Kovaç dhe punimet do të vazhdojnë dhe në akset e tjera rrugore.

Sot prita në takim një përfaqësi të banorëve të Lagjes Partizani me të cilët bashkëbiseduam në lidhje me projektin e realizuar për rehabilitimin, rikonstruksionin dhe sistemimin e kësaj lagjeje.

Varësisht temperaturave të ulëta, ngricave dhe borës jemi gjendur kudo, për të siguruar që çdo aks rrugor të jetë funksional dhe të ketë liri lëvizje për banorët. Falendërime për Ekipin e Emergjencave Civile Tropojë dhe çdo punonjës të administratës që është në krye të punës për përballimin e situatës së vështirë të emergjencave.

02 MARS: Sot sëbashku me banorët e zonës ndoqëm punimet që po bëhen nga ekipi i Bashkisë Tropojë në rrugën e fshatit Lug i Zi ,Njësia Administrative Tropojë.

03 MARS:

Gjeneral Nexhmi Krasniqi dhe kolegët e tij ishin mysafirë në Tropojë dhe pata jo vetëm kënaqësinë ti prisja, por dhe të diskutonim mbi gjithë problematikën ekonomike e sociale që shqeteson komunitetet tona.

ashtu i lumtur që Këshilli Bashkiak Tropojë pranoi kërkesën time për shpalljen"Qytetar Nderi" të Zotit Krasniqi.

Sloganit tim "Së bashku për Tropojën" vijoj ti qëndroj me insistim.

Këto pamje janë nga puna për rikonstruksionin e rruges Bujan-Gri- Geghysen, një investim i Bashkisë Tropojë

05 MARS: Sot firmosa kontraten me qeverinë japoneze dërguar nga Ambasada Japoneze në Tirane.Pas aplikimit nga ana jonë kemi rezultuar fitues të një granti të rëndësishem,që ka të bëjë me lëvrimin e menjëhershem të një fondi për blerjen e makinerive dhe pajisjeve moderne për grumbullimin e mbetjeve urbane.

Gëzuar 7-Marsin ju që i keni dhënë dhe i jepni dritë, frymë dhe shpirt mendjes, dijes, kulturës dhe traditës sonë shpirtërore dhe atdhetare.

Dëtyra juaj sot, dhe çdo ditë është të përcillni frymën e përkushtimit dhe punës tuaj me pasion, ashtu të pastër te brezat e ardhshëm.

Faleminderit dhe njëherë për punën tuaj sidomos të këtyre ditëve të vështira ku gjendemi.

Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 -Marsi, në njërën anë numëron përpjekjet dhe shënon arritjet e grave , por në anën tjetër këmbëngul në barazi, në kushte e mundësi, si në rrafshin ekonomik,ashtu edhe në atë politik.Ndaj është detyra jonë që ta marrim seriozisht për të kuptuar se sa e rëndësishme është që në botë të ekzistojë barazia gjinore.Faleminderit të gjitha grave për rolin dhe kontributin e tyre.

Lajm i shumëpritur, fillon ndërtimi i objekt banimit 6 kat për strehimin e 25-familjeve.

Vazhdojnë punimet për ndërtimin e urës në fshatin Markaj ,Lagjjia Breçan.

Investim ky i domosdoshëm, që jo vetëm shmang izolimin e banorëve, por dhe mundëson lehtësi lëvizje për komunitetin.

10MARS: Ka nisur puna për asfaltimin e rrugës së fshatit Kërrnajë.Kjo rrugë është e shumëpritur nga banorët e zonës e cila do të bëhet realitet, pas dhjetëra e dhjetëra vitesh pritje e premtime.Investimi në këtë segment rrugore përveçse do të shkurtojë e lehtësojë ndjeshëm lëvizjen drejtë qytetit, do të sjellë tjetër impuls zhvillimi për zonën.

24 MARS: Nga sot hapet aplikimi për mbeshtetje financiare për fermerët.

31 MARS: Shoshan.Përjetësisht i lidhur me trollin, me njerëzit e vendit tim, gjithmonë kam qenë këtu për të bashkëbiseduar, për të ndarë të mirat dhe problemet sëbashku. Unë jam këtu dhe do të jem nuk rikthehem por jam gjithmonë tek rrënjët.

.

21 PRILL: Rifillojnë punimet në rrugën e fshatit Brisë, ku shkak i ndërprerjes kanë qënë vetëm kushtet klimaterike. Kjo rrugë nuk është më ëndrra shekullore e banorëve të Brisës, as premtim por një zotim i mbajtur, që do përfundojë shumë shpejt.

05 MAJ: Tropoja e ka të shtrenjtë historinë e saj dhe krenohet nder brezni me bijtë e bijat që dhanë jetën e tyre për trojet amtare.Eshte detyra jonë me fisnike jo vetëm ti nderojmë përjetësisht, por dhe të transmetojmë mesazhin e tyre atdhetar.Ndjehem borxhli,por dhe krenar që në pak kohë në krye të Bashkisë Tropojë mundësuam fillimin e riparimit të Kompleksit të Varrezave të Dëshmorëve me një fond prej 2 milion lekë të reja.

09-10 MAJ: Për dy ditë radhazi unë dhe bashkëqytetarët e mi patëm privilegjin të ishim mikpritës te Ambasadorit te BE-se në Shqipëri Luigji Soreca, i cili shoqërohej nga ambasadorët e Francës,Austrisë,Spanjës si dhe stafet e tyre diplomatike. Ata kishin zgjedhur Tropojën për të festuar Diten e Europes.

12 MAJ: Sot sëbashku me Ing.Hazir Isufaj inspektuam vazhdimin e punimeve të ndërtimit për objektin e banimit dhe shërbimit 6 katësh, për strehimin e 25 familjeve. Falenderime për Drejtorin e Përgjithshëm të EKB Z.Stefan Çipa për korrektësin dhe bashkëpunimin.

29 MAJ: Sot së bashku me Zv. Kryetarin e Bashkisë Z.Kujtim Rexha inspektuam punimet që po kryhen për asfaltimin e rrugës së fshatit Geghysen.Ky investim përveç se do të lehtësojë lëvizjen e banorëve do i jap një zhvillim të jashtëzakonshëm zonës në fokusin e agroturizmit.

31 MAJ: Vazhdojnë punimet për hapjen e rrugës në Bjeshkën e Sylbicës e cila ka pësuar shumë dëmtime si pasojë e dimrit të vështirë.Ndër breza kjo bjeshkë verohet nga fiset e Bytyçit të cilët krahas staneve vitet e fundit kanë nisur të ndërtojnë vila e hotele për të pritur turistë.Natyra i dhuroi Tropojës Bjeshkët, por koha është që ti ruajmë dhe gëzojmë të gjithë.

01 QERSHOR: Gëzuar 1 Qershorin ditën e fëmijëve! “Nuk ka asgjë më të çmuar për një prind sesa një fëmijë, dhe asgjë më të rëndësishme për të ardhmen tonë sesa siguria e të gjithë fëmijëve tanë."

02 KORRIK: Punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve të Bashkisë Tropojë kanë filluar punën për rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e kanalit vaditës së Krasniqes mirëfunksionimi i të cilit ka rëndësi jetike për tokat bujqësore të zonës.

04 KORRIK: Bashkia Tropojë në bashkëpunim me institucionet e tjera u përfshin sot në një aksion për të ndihmuar në procesin e ruajtjes së mjedisit jetësor, si detyrë e çdo qytetari, që të promovojë dhe mbrojë ambientin jetësor dhe natyrën në zonën e tyre lokale.Të gjithë jemi të detyruar të japim kontributin tonë personal në respektimin dhe praktikimin e vazhdueshëm, si kusht për një mjedis të pastër jetësor.

10 KORRIK: Ishte privilegj i veçantë të kisha sot mysafir në Tropojë dhe në zyren time Akademik Jusuf Buxhovin.Integrimi europian i shqiptareve nuk vjen i natyrshëm pa integrimin kulturor, shpirtëror dhe nacional.Surprizë e veçantë kjo vizitë ne trollin e Mic Sokolit, Ali Ibrës, Haxhi Zekës,Bajram Currit,Tahir Sinanit e Bylbyl Breçanit, të një mendje te çmuar si Akademik Buxhovi!

12 KORRIK: Së bashku me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit Z. Blendi Klosi, grupe e shoqëri artistike mbarëkombëtare, shumë miq e personalitete çelem dje sezonin turistik në Valbonë.

26 KORRIK: Se bashku me Zv/Prefektin e Qarkut Kukes z.Mujo Gosturani sot inspektuam punimet intensive qe po kryhen ne realizimin e projektit të kanalizimit dhe sistemimit të ujërave të zeza në zonën turistike Valbonë.Ky investim i domosdoshëm i qeverisë shqiptare do të rregullojë përfundimisht këtë problem madhor për komunitetin dhe mbarëvajtjen e turizmit.

28 KORRIK: Sot në Bajram Curri e ndjeva mikpritjen dhe ngrohtësinë që reflekton Malësia. Me këtë rast, kam ndarë medaljen "ME BESIM NË ZOT, ATDHE E SHTET" për të rënët për liri, Tahir Sinani, Fatmir Doçi, Bilbil Breçani, telekronistin Ismajl Buçpapaj, Bashkinë e Tropojës dhe Unionin Artistik të Kombit Shqiptar. Ju faleminderit për mikpritjen e përzemërt! RAMUSH HAJREDINAJ

29 KORRIK: Ndoshta jemi unik në Shqiperi si Bashki që krahas përballimit të situatës emergjente të vapës afrikane vijojmë sistematikisht të hapim rrugët e bjeshkëve nga dëbora e depozituar gjatë dimrit.

21 KORRIK: Së bashku me N/Kryetarin e Bashkisë z. Kujtim Rexha sot u riktheva sërish në Lugun e Tropojës për të inspektuar përfundimin e punimeve të urës, e cila lidh përfundimisht banorët e kësaj zone të harruar e neglizhuar në 30 vite.

Eshtë në hapat e fundit drejt përfundimit ura që lidh fshatin e bukur e turistik Markaj dhe pikërisht lagjen Breçan, të Bashkise Tropojë,Jam sinqerisht i lumtur që me së fundi po arrijmë në kohë rekord të plotësojmë këtë kërkesë të kahershme e jetike të këtij komuniteti.

01 GUSHT: Pata nderin të pres në Valbonë Ambasadorin e Japonisë Sh.T.Takada Mitsuyuki i shoqëruar nga Konsulli i Përgjithshem i Nderit, z.Avni Ponari.I shpreha Ambasadorit mirënjohjen e falenderimin tim dhe të komunitetit të Tropojës për kontributin e vazhdueshem të qeverisë japoneze sidomos në fushen e infrastrukturës shkollore dhe të turizmit ,i cili pak ditë me parë u kurorëzua nga një grant prej 100.000 $.

04 GUSHT: Në praninë e qindra bjeshktarëve të Bytyçit si dhe mysafirëve e turistëve të shumtë, sot vijuam turin promovues të Bjeshkëve në Sylbicë.

10 GUSHT: Pas një ndërhyrje që vijon te Varrezat e Dëshmorëve, shërbimet tona bashkiake po merren me pastrimin dhe rregullimin e infrastrukturës në varrezat publike të qytetit.



14 GUSHT: Sot mbushen 2 vite nga mandati im në krye të Bashkise Tropojë.Janë 2 vite sfidë, jo vetëm për shkaqe të cilat po i përjeton gjithë njerëzimi, por dhe për specifikat dhe trashëgiminë aspak serioze që gjetëm në institucion. Por besoj se ja dolëm me mbështetjen dhe mirëkuptimin e qytetarëve.

26 GUSHT: Së bashku me ing.Kujtim Rexhën,n/Kryetar i Bashkisë Tropooje riinspektuam gjëndjen e pemëve të mbjella në rrugën nacionale dhe segmentet e tjera infrastrukturore.Ky është një investim i thjeshtë në dukje, por në thelb është një prespektive ekologjike, që do ju shërbejë brezave tanë për një Tropojë të gjelbër,turistike siç vetë Zoti e ka krijuar.

28 GUSHT: Shpirtërisht i lumtur dhe i nderuar që sot vura gurin e parë në themelet e Tyrbes së Shenjtë të Sari Salltikut, në Majën e Shkëlzenit.I shoqëruar nga stafi im, në praninë e klerikëve të nderuar nga Tropoja e Kosova,në mes qindra pelegrinëve, ne u lutëm për me të mirën për Tropojën tonë dhe njerezit e saj të mrekullueshëm.

02 SHTATOR: Vizitën time të punës në Bruxelles pata kënaqësinë ta filloj i mirëpritur nga n/Kryetari i Komunës Namur, z. Adnand Rexhepi me origjine shqiptare. Një Komunë në qendër të Evropes, që numëron rreth 7000 shqiptarë.

08 SHTATOR: Sinqerisht i lumtur sot që i shoqëruar nga zv/Kryetari i Bashkise ing.Kujtim Rexha dhe pjestarë nga stafi im i Integrimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj mora pjesë dhe nënshkrova në Hotel Rogner, Memorandumin e Bashkëpunimit të Konsortiumit me BE "Për vullnetarizëm të qëndrueshëm lokal".Tropoja u listua nga institucionet dhe organizatat ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri përkrah bashkive më të mëdha të vendit, në këtë projekt pilot që do vijojë per 3 vite.

23 SHTATOR: Sot në Tiranë isha i privilegjuar veçanërisht ti dorëzoj medaljen e akorduar "Mirënjohja e Tropojës" z. Charles McGonigal, një ish personalitet i rëndësishëm, me gradën SAC i Agjensisë me të fuqishme investigative në glob, FBI.

09 TETOR: Sot me emocion njerëzor të veçantë, mes burrave fisnik të Nikaj-Merturit pata kënaqësinë të dorëzoj në ambientet e Muzeut Historik të Tropojës, dekorimin nga Këshilli Bashkiak "Qytetar Nderi" për z. Dedë Malaj (pas vdekjes).

28 TETOR: Vendlindja jonë është si ky stadium i rindërtuar....ka jo vetem vend, por dhe nevojë per prezencën dhe kontributin e gjithësecilit.



30 TETOR: "Dita e gështenjës" kjo festë lokale e cila po kthehet në traditë, u kthye sot në një manifestim kulturor, artistik, kulinar dhe promocional me pjesëmarrje masive të bashkëqyetarëve tanë por dhe dhjetra mysafirëve nga vendi, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve.

06 NËNTOR: 77-Vjet me parë në Tropojë u krijua Brigada XXV.S. Ky organizim i rëndësishëm partizan i dha luftës në pak kohë 53 dëshmorë, dhe u shqua për heroizmin e saj kundër nazi-fashizmit edhe jashtë kufijve shtetërorë e nacionalë.

15 NËNTOR: Pas krijimit të Komisionit të Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Tropojë sot drejtova mbledhjen e radhës, në prani të anëtarëve pjesëmarrës si dhe drejtuesve kryesore të institucioneve kryesore.

16 NËNTOR: Ambienti dhe natyra, janë dhuratat më të bukura që Zoti ja ka falur Tropojës.Uji është bekimi i Perëndisë.Ndaj sot pata kënaqësinë të udhëheq me stafin tim në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore dhe organizata të Shoqërise civile inicimin e një aksioni sistematik për mbrojtjen dhe miradministrimin e ujit.

20 NËNTOR: "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve" për më tepër në këtë situatë të rëndë ngjarjesh makabre ndaj tyre merr një kuptim të veçantë për mua dhe Stafin tim të QFK-së, pranë Bashkisë Tropojë.Ndaj me një aktivitet masiv,me pjesemarrjen e ZVA -së dhe Shoqërise civile, sot u kremtua kjo ditë larmishëm në Qytetin Bajram Curri.

25 NËNTOR: Një ditë e gjatë por dhe shumë e mirëpritur për mua në Nikaj Mertur.E fillova ditën në Lekbibaj ku në prani të komunitetit,të autoriteteve vendore mora pjesë në ceremoninë e emërtimit të Qendrës Shëndetësore "Dr.Gjergji Papleka". Ky personalitet i mjekësise shqiptare i bën nder me emrin e tij jo vetëm vendlindjes se tij ,por mbarë Tropojës e më gjerë.

I lumtur dhe i emocionuar sot që ndodhem në Nikaj-Mertur, që vij me një premtim të vështirë, por të mbajtur: Hapjen e rrugës automobilistike që lidh fshatin Brisë.

Nuk ishte nje premtim electoral, por një besë burrash me burrat e Nikaj-Merturit.

03 DHJETOR: Ndonëse të padeshiruara, fatkeqësitë jane te pashmangeshme.E tille ishte dhe djegia e shtëpisë së bashkëqytetarit tonë nga fshati Markaj Fatmir Toska.Falë zotit nuk pati dëme njerëzore, përveç atyre materiale.Menjeherë i shoqëruar nga n/Kryetarët e Bashkisë Kujtim Rexha dhe Abedin Kërrnaja si dhe specialistët e Departamentit të Emergjencave civile shkuam në vendngjarje për t'ju gjendur pranë familjarëve

Bashkia Tropojë me të gjithë mundësitë dhe fondet e saj modeste po punon pa ndalesë që ujërat si këto në Kanalin e Gashit të sistemohen me projekte afatgjata.

Megjithë kushtet klimaterike jo aq të përshtatshme dhe disa pengesa te paarsyeshme, Bashkia Tropojë vijoi sot intensivisht rehabilitimin e Unazës së Qytetit. Ky projekt jo vetëm zgjidh përfundimisht trafikun dhe afron shërbimet për qytetarët ,por e kthen qytetin tonë në një atraksion të këndshëm turistik.

Në pragun e Festës së Shenjtë të Krishtlindjes dhe afrimit të ndërrimit të viteve ,Bashkia Tropojë e celebroi festimin me ndezjen e dritave në bredhin symbol, por dhe në të gjithë qytetin.Eshte shumë i rëndësishëm ky festim sivjet si një traditë njerëzore ,për vetë faktin se kaluam një vit të vështirë nga pandemia, ndaj i quajta të domosdoshme këto çaste gëzimi e lumturie këtu në skajin alpin të Atdheut.

1

7 DHJETOR: Në këtë prag festash të Krishtlindjeve dhe ndërrimit të viteve, nuk mund të mos ndaja momente mjaft të këndshme e frymezuese me të rinjtë e Tropojës.Tropoja është e shquar për rininë e talentuar dhe entuziaste, e cila është premisa e sigurtë jo vetëm e jetëgjatësisë njerëzore, por dhe e përçimit të vlerave,traditave, zakoneve, që na kanë veçuar në histori si komunitet solid dhe krenar.

19 DHJETOR: Sot isha i nderuar që së bashku me familjarët e bashkëqytetaret e Heroit të Kosovës Bylbyl Breçani prita dhe Komandantët e UÇK-së,përkatësisht ish - Ministra të Mbrojtjes Rrustem Berisha e Anton Çuni, të përkujtojmë aktin heroik të këtij biri të denjë të Malësisë së Gjakovës.Dhe jo vetëm përkujtimin, por dhe nderimin me të lartë për Bylbyl Breçanin, pasi në lartësitë e qytetit e pikërisht në rrugën që mban emrin e tij ,do të ngrihet Shtatorja e Heroit.

Nuk mund te mbyllej ky vit pune e përpjekjeje pa kontributin e te rinëve punëtorë e të përkushtuar të Bashkisë Tropojë.Gjatë gjithë punës time si drejtues në shërbimin publik kam pasur objektiv primar afrimin dhe punësimin e te rinjve.Ata janë ardhmeria jonë, por dhe energjia e vertetë, të cilën e kërkon koha sot.

23 DHJETOR:

Nderimi i gjithë bijve dhe bijave të Tropojë, që me punën, talentin,ndershmërinë,korrektesën e veçantë në shërbimin publik,me qytetarinë e virtytet e larta kanë lënë gjurmë të pashlyera në memorien e Malësisë së Gjakovës,ka qenë dhe ngelet synimi im konstant si një frymëzim për brezat që vijne. Edhe sot në një ceremoni të thjeshtë, por të prekshme i ndava titullin e akorduar "Qytetar Nderi"(pas vdekjes) mjeshtrit të fotografisë dhe sinonimit të qytetarisë e urtësisë Mustaf Memia.

25 DHJETOR: Edhe në ditë feste në punë, me gjithë stafin tim, duke besuar se kështu është më i miri urim. Dhe pikërisht në Qafë Prushi, me të gjitha mjetet që disponojmë, duke riparuar këtë segment të rëndësishëm e jetësor për banorët e Bytyçit.

Tropoja ka ndezur dritat e festive dhe të optimizmi!

30 DHJETOR: Si njeë dhuratë e bukur në prag të ndërrimit të viteve vjen dhe prezantimi dinjitoz i artistëve të vegjël, të talentuar të Tropojës, në Festivalin e II –të Mbarëkombëtar të Interpretuesve të Këngës Popullore, organizuar në Durrës.Çmimi i parë për interpretim si dhe Çmimi i ll-të për videoklipin më të mirë ju takoi nxënësve tropojanë Adela Shiqerukaj dhe Helena Toskaj.

Sot pata kënaqësinë të jem në një festë fundviti me stafin tim dhe autoritetet e Tropojës. Ishte festimi i një bilanci pozitiv pune dhe përpjekje të përbashkët në shërbim të komunitetit në një kohë të vështirë për të gjithë njerëzimin.Puna dhe shërbesa ka qenë dhe mbetet objektivi im ,por ndjehem mirë kur Tropoja, vendlindja jonë feston e gëzon!

ALBUM FOTOGRAFIK

ALI IBËR NEZAJ
© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

DIMRI I VALBONES

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

© Shkëlzen REXHA

PERMBAJTJA

1.Fjala hyrëse e kryetarit të bashkisë. Faqe 2-3

2.Drejtoria e turizmit, sherbimeve dhe transportit. Faqe 4-14

3.Punime dhe rikonstruksione të rrugëve dhe objekteve. Faqe 15-16

4.Sektori I emergjencave civile dhe turizmit. Faqe 16-24

5.Sektori I bujqësisë, zhvillimit rural dhe trajtimit të ATMP. Faqe 25-27

6.Histori e urbanistikës dhe ndertimtarisë në Tropojë. Faqe 28-33

7.Për punën e kryer nga sektori I pyjeve dhe kullotave. Faqe 34-39

8.Sektori I Ujitjes. Faqe 39-42

9.Zyra e integrimit evropian. Faqe 42-45

10.Qendra kulturore e fëmijëve. Faqe 46-48

11.Sektori I burimeve njerëzore. Faqe 48-50

12.Veprimtaria e këshillit bashkiak. Faqe 51-53

13.Sektori zjarëfikës. Faqe 54-55

14.Veprimtaria e QKB-së. Faqe 56-57

15.Roli dhe veprimtaria e policies bashkiake. Faqe 58-60

16.Drejtoria ekonomike. Faqe 61-63

17.Copëza nga ditari vjetor I veprimtarisë së kryetarit të bashkisë. Faqe 63-96

18.Album fotografik nga Tropoja/Dimri I Valbonës. Faqe 97-